

Stabiliteti Financiar



Si përkufizohet Stabiliteti Financiar?

Stabiliteti financiar mund të definohet si një situatë në të cilën **komponentët e sistemit financiar** (*tregjet financiare, ndërmjetësit financiar dhe infrastruktura financiare*) funksionojnë me aftësinë për të përballuar goditjet pa shkaktuar disbalanca financiare, që tutje ndikojnë negativisht në gjithë ekonominë reale.

<https://www.ecb.europa.eu/pub/financial-stability/html/index.en.html>



Komponentët e sistemit financiar:

Ndërmjetësit financiar: Bankat, Kompanitë e Sigurimeve, Institucionet Mikrofinanciare, Institucionet Financiare Jobankare, Këmbimore, etj.

Tregjet financiare: Tregu i parave, Tregu i kapitalit

Infrastruktura financiare: Sistemi i pagesave

Rëndësia e stabilitetit financiar

Stabiliteti financiar ka rëndësi të veçantë, si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë social, si parakusht për zhvillimin e shëndetshëm ekonomik dhe mirëqenien e të gjithëve për shkak se pjesa më e madhe e transaksioneve, në ekonominë e vendit kryhet përmes sistemit financiar.

Një sistem financiar jo stabil, mund të shkaktojë krizë financiare me pasoja negative të përhapura në gjithë ekonominë.

Prandaj, është thelbësore që një sistem financiar të jetë i shëndoshë dhe i qëndrueshëm, që mbështet shpërndarjen efikase të resurseve/burimeve përmes funksioneve të tij ndërmjetësuese dhe që siguron kapacitetet absorbuese ndaj rreziqeve të mundshme që e kanosin stabilitetin e tij.

<https://www.worldbank.org/en/publication/gfdr/gfdr-2016/background/financial-stability>



Kur konsiderohet stabil një sistem financiar?

Sistemi financiar mund të konsiderohet stabil, kur kryen funksionet e tij të ndërmjetësimit financiar dhe të menaxhimit të rreziqeve, duke ndihmuar publikun dhe subjektet ekonomike në kryerjen e transaksioneve financiare të lidhura me kursimin, investimin, huamarrjen, kryerjen e pagesave dhe menaxhimin e rreziqeve nga ngjarjet negative dhe të paparashikueshme (siç ishte kriza financiare globale në 2008 dhe aktualisht kriza me pandeminë COVID 19).



Cili është roli i BQK-së në ruajtjen e Stabilitetit Financiar?

Banka Qendrore ka rol fundamental në nxitjen dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në Kosovë, si autoritet rregullativ dhe mbikëqyrës i sektorit financiar (bankave komerciale, institucioneve mikrofinanciare, institucioneve financiare jobankare, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, etj), si dhe duke promovuar një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave.



Si e monitoron BQK zbatimin e politikave në ruajtjen e Stabilitetit Financiar?

BQK përcakton rregulloret dhe poilitikat e përgjithshme të funksionimit të sistemit financiar dhe pastaj përmes tyre monitoron aplikimin e tyre në praktikë.

BQK vlerëson dhe monitoron nëse politikat e përgjithshme të sistemit financiar, janë në harmoni me aktet juridike dhe të njëjtat ofrojnë një sistem financiar stabil nëpërmes:

- sigurimit të depozitave,
- operacioneve të tregut,
- likuiditetit emergjent;
- rregullimit, licencimit, regjistrimit dhe mbikëqyrjes së institucioneve financiare;
- mbikëqyrjes së sistemeve të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase të pagesave;
- sigurimit të furnizimit me kartëmonedha dhe monedha në Kosovë.



Me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar, BQK ka miratuar Politikën për Makroprudencë <https://bqk-kos.org/repository/docs/2015/Politika%20per%20Makroprudence%2010%2008%202016.pdf> për identifikimin, monitorimin dhe analizimin e vazhdueshëm të rrezikut sistemik (*rreziku i çrregullimeve në ofrimin e shërbimeve financiare, që kanë pasoja negative për ekonominë në përgjithësi*).

Identifikimi i rreziqeve potenciale bëhet përmes analizës së vazhdueshme të treguesve ekonomik e financiar si dhe parashikimeve makroekonomike.



Rreziqet kryesore të cilat mund të destabilizojnë një sistem financiar e të cilat monitorohen rregullisht nga Banka Qendrore janë:

- *rreziku kreditor,*
- *rreziku i likuiditetit,*
- *rreziku i solvencës,*
- *rreziku i tregut,*
- *rreziku operacional.*




Publikimet e BQK-së

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) vazhdimisht analizon dhe publikon raporte periodike dhe joperiodike mbi zhvillimet ekonomike në vend, me theks të veçantë në zhvillimet e sektorit financiar <https://bqk-kos.org/publikimet/>. Publikimi i këtyre informatave është shumë i rëndësishëm për publikun, për të kuptuar se cila është gjendja e përgjithshme në të cilën ndodhet sistemi financiar në përgjithësi dhe sektorët e tij në veçanti.



Kush përfiton nga stabiliteti financiar?

Nga stabiliteti financiar përfitojnë të gjithë (qytetarët, bizneset dhe ekonomia në tërësi), sepse në kushtet e stabilitetit financiar të gjithë akterët ekonomikë ndërveprojnë pa pengesa, me një qasje të lehtë në shërbime dhe produkte financiare (*kryerjen e pagesave dhe transkacioneve të ndryshme, mundësi kreditimi, depozita të sigurta, investim në biznes, etj.*), gjë që rezulton në rritjen e vazhdueshme të besimit në sistemin financiar e si rrjedhojë edhe në rritjen ekonomike të vendit.





BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Adresa: Rr. Garibaldi nr.33,
Prishtinë, Kosovë

www.bqk-kos.org

E-mail: info@bqk-kos.org

Telefon: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763